



ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
ENERGY REGULATORY OFFICE
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU

Raporti Konsultativ për Parimet e Përcaktimit të ngarkesave

Përgjigjet ndaj Komenteve

DEKLARATË

Ky dokument i përgjigjeve është përgatitur nga ZRRE në mënyrë që të adresohen komentet nga palët e interesit. [Ky dokument nuk përfaqëson vendim të ZRRE-së.](#)

18 korrik 2012

Tabela e përmbajtjes

1	Hyrje	1
2	Struktura e këtij dokumenti	1
3	Komentet e të licencuarve dhe përgjigjet e ZRRE-së	1
3.1	Përkufizimi për lidhjet “thellë” dhe “cekët”	1
3.2	Zhvillimet e ardhshme në treg.....	2
3.3	Masat për menaxhimin e kërkesës.....	2
3.4	Refuzimi i dhënies së qasjes	2
3.5	Periudha kohore për ofrimin e ofertës.....	3
3.6	Përcaktimi i ngarkesës për mirëmbajtje.....	3
3.7	Zhvlerësimi i asetëve të paguara nga konsumatorët	3
3.8	Kërkesat për informata nga parashtruesit e kërkesave	4
3.9	Kyçjet për ngarkesa	4
3.10	Marrëveshjet kontraktuese	4
3.11	Hyrja e ngarkesave në fuqi	5

1 Hyrje

Zyra e Rregullatori për Energji (ZRRE) i ka lëshuar draft dokumentet si në vijim për konsultim më datë 22 qershor 2012:

- Parimet e përcaktimit të ngarkesës për shpërndarje
- Parimet e përcaktimit të ngarkesës në transmision

Komentet për dokumente janë pranuar nga KEK dhe KOSTT.

Disa nga komentet ishin minore për nga natyra dhe se janë inkorporuar ndryshimet e përshtatshme në versionet përfundimtare të dokumenteve. Të licencuarit ofruan ndryshime të mëtutjeshme të sugjeruara me qëllim të ofrimit të informatave apo hollësirave shtesë në lidhje me aspektet e përcaktimit të ngarkesave. ZRRE jo domosdoshmërisht pajtohet me pikat e ngritura por i konsideron ato të papërshtatshme në dokumente të cilat i adresojnë parimet e përcaktimit të ngarkesave; janë të licencuarit ata që duhet të konsiderojnë nëse këto duhet të inkorporohen në metodologjitë e tyre të përcaktimit të ngarkesave.

Pika tjera të natyrës më substanciale janë ofruar nga të dy të licencuarit. Qëllimi i këtij dokumenti të përgjigjeve është që t'i këshilloj palët e interesit me pikëpamjet e ZRRE-së për këto komente dhe se si ZRRE i ka trajtuar ato gjatë finalizimit të dokumenteve.

ZRRE i ka aprovuar dhe lëshuar versionet përfundimtare të dy dokumenteve më 18 korrik 2012.

2 Struktura e këtij dokumenti

Dy draft dokumentet mbi parimet e përcaktimit të ngarkesave janë të ngjashme për nga forma dhe mbulojnë në mënyrë të gjerë çështje të ngjashme në lidhje me përcaktimin e ngarkesave për shfrytëzim të sistemeve përkatëse të licencuarve për shpërndarje dhe transmision. Në përgjigjet e tyre, të licencuarit ofruan komente mbi tema të ndryshme në dokumente dhe në të shumtën e rasteve dhanë përgjigje në çështjet e njëjta. Ndërsa ZRRE i ka zhvilluar dokumentet paralelisht dhe dëshiron të ketë qëndrueshmëri në mes tyre, duket e përshtatshme që komentet të adresohen në bazë të temave në vend se t'i marr përgjigjet nga të licencuarit radhazi. Përvijimet e komenteve të të licencuarve dhe përgjigja e ZRRE-së janë dhënë në pjesën tjetër të këtij dokumenti.

3 Komentet e të licencuarve dhe përgjigjet e ZRRE-së

3.1 Përkufizimi për lidhjet “thellë” dhe “cekët”

KEK ka sugjeruar që përkufizimit e lidhjes “thellë” t'i shtohen fjalë shtesë. ZRRE konsideron që shtesat e sugjeruara janë të panevojshme ngase fjalët shtesë e dyfishojnë frazën ekzistuese.

KOSTT ka komentuar në të dyja përkufizimet. ZRRE konsideron që formulimi të cilin e ka propozuar KOSTT është i arsyeshëm, ndonëse për arsye të balancimit, ZRRE e ka modifikuar pak propozimin e KOSTT që të përdoret formulimi i njëjtë për të dy përkufizimet. ZRRE konsideron që është e përshtatshme që të bëhen modifikimet e njëjta në të dy dokumentet për përcaktimin e ngarkesave të OST dhe OSSH.

Përveç kësaj, ZRRE mendon që duke marrë parasysh këto dokumente, përkufizimi i “kapacitetit efektiv” mund t’i ofrojë udhëzim të dobishëm të licencuarve dhe parashtruesve të kërkesës për kyçje. Prandaj, kjo është inkorporuar në Nenin 3.1 në të dy dokumentet.

3.2 Zhvillimet e ardhshme në treg

KEK ka kundërshtuar dispozitën e cila kërkon ngarkesa për pasqyrimin e zhvillimeve të ardhshme në treg dhe e ka konsideruar këtë si një ndërlikim të tepruar. KOSTT nuk u pajtua me pikëpamjen e KEK-ut. Pikëpamja e ZRRE është që dështimi i strukturës së përcaktimit të ngarkesave për të akomoduar zhvillimin e sektorit, siç është shitja e distribucionit apo licencimi i gjeneratorit të pavarur operues termik, mund të parandalonte që këto ndryshime të mos futen në mënyrë efikase jo-diskriminuese dhe ekonomike. Prandaj, ZRRE ka konkluduar se dispozita duhet të qëndrojë në dokumente.

3.3 Masat për menaxhimin e kërkesës

KEK vëren se masat për menaxhimin e kërkesës nuk gjejnë aplikim praktik në Kosovë aktualisht, pa ofruar ndonjë arsyetim për atë deklaratë.

KOSTT thekson se në mënyrë që të merret parasysh ndikimi i masave të kërkesës mbi përcaktimin e ngarkesave, KOSTT-it do t’i duhet dukshmëri më e madhe mbi veprimet e furnitorëve. Ata propozuan që kjo mund të arrihet më së miri përmes ndryshimeve në Kodin e rrjetit.

Në përgjigje të pikëpamjes së KEK-ut, pikëpamja e ZRRE-së është se masat për kursimin e energjisë kanë po atë rëndësi të madhe në Kosovë sa e kanë edhe në çdo vend tjetër – ndoshta edhe më shumë pasi që resurset e energjisë së Kosovës mbesin të kufizuara. Prandaj, dispozita përkatëse është mbajtur në të dyja parimet për përcaktimin e ngarkesave të OSSH dhe OST.

Duke iu përgjigjur sugjerimit të KOSTT, ZRRE konsideron që ky mund të jetë një hap mjaft i përshtatshëm për ta ndërmarrë dhe kërkon që KOSTT ta konsideroj këtë edhe më tutje si “pronar” i Kodit të rrjetit.

3.4 Refuzimi i dhënies së qasjes

KEK propozoi që një nga arsyet për refuzimin e qasjes për sistemin e shpërndarjes është borxhi i mbetur nga të licencuarit. ZRRE nuk mendon që kërkohet ky amendamentim. Nëse KEK-u mendon që kjo dispozitë është e përshtatshme atëherë KEK-u mund ta propozojë këtë në metodologjinë e saj

për përcaktimin e ngarkesave. ZRRE do ta konsideroj arsyeshmërinë e një propozimi të tillë në kohën e duhur.

3.5 Periudha kohore për ofrimin e ofertës

KEK sugjeroi që të ketë zgjatje në periudhën e propozuar kohore për ofrimin e ofertës për kyçje, pas pranimit të kërkesës, nga 28 ditë në 30 ditë për kyçjet me TU dhe në 90 ditë për kyçjet me TM dhe me TL. ZRRE vëren se puna e nevojshme për përgatitjen e një ofertë për kyçje do të ishte më e rëndësishme në tensionet më të larta. Prandaj, ZRRE i ka caktuar periudhat kohore të lejuara në 30 ditë për TU, 45 ditë për TM/TL dhe në 90 ditë për TEL.

Periudha përkatëse në dokumentin e OST-së është caktuar në 90 ditë për qëndrueshmëri dhe për t'i reflektuar ekzaminimet shtesë që mund të kërkojnë për kyçjet komplekse në nivel të transmisionit.

3.6 Përcaktimi i ngarkesës për mirëmbajtje

KEK ka komentuar që është më e drejtë për t'i përfshirë kostot e mirëmbajtjes për shfrytëzimin e përcaktimit të ngarkesave për sistemin, në vend të përcaktimit të ngarkesave për kyçje, dhe ka propozuar që ZRRE të fshijë deklaratën e cila kërkon që metodologjia për kyçje të deklarojë se si do të trajtohen kostot e mirëmbajtjes për asetet e kyçjes. KOSTT nuk pati kundërshtim ndaj draft propozimit të ZRRE-së.

ZRRE nuk pajtohet me largimin e kësaj dispozite nga Parimet për përcaktimin e ngarkesave ashtu siç sugjeron KEK-u. Nëse KEK-u dëshiron të propozojë që kostot për mirëmbajtje të aseteve të kyçjes të rikthehen përmes DUoS, atëherë kjo duhet të përfshihet në metodologjinë e saj të propozuar për të dyja, kyçjen dhe shfrytëzimin e sistemit.

3.7 Zhvlerësimi i aseteve të paguara nga konsumatorët

KEK komentoj që zhvlerësimi nuk duhet lejuar në ato asete që paguhen direkt nga konsumatori ngase po të veprohet ashtu do të përfshinte konsumatorin në pagesën e dyfishtë. KOSTT gjithashtu sugjeroi që ishte i nevojshëm shpjegimi shtesë për këtë çështje.

Aty ku konsumatori paguan për asetet e veta për kyçje, këto asete nuk bëhen pronë e konsumatorit, por e të licencuarit dhe zëvendësimi përfundimtar i këtyre aseteve do të jetë përgjegjësi e të licencuarit. ZRRE konsideron që aty ku asetet janë paguar nga kontributet e konsumatorit, vlera e atyre aseteve duhet t'i shtohet bazës së aseteve të rregulluara të të licencuarit por se shuma e kontributeve të konsumatorit duhet të zbritet nga të hyrat e të licencuarit. Dispozitat e dy dokumenteve janë modifikuar për të pasqyruar këtë pozitë.

3.8 Kërkesat për informata nga parashtruesit e kërkesave

KEK sugjeron që kërkesat për hollësi të informatave dhe format që do të përcaktohen për konsumatorë në metodologji është mikro menaxhim nga ZRRE. KOSTT në parim nuk ka kundërshtuar këtë dispozitë por ka propozuar disa sqarime të kërkesave nga parashtruesit e kërkesave.

ZRRE konsideron se parimet e qasjes së palës së tretë kërkojnë transparencë dhe jo diskriminim. Prandaj është krejtësisht e arsyeshme që të licencuarit të bëjnë shpalosjen e plotë të informatave për konsumatorët potencial – informatave që janë të nevojshme para se kërkesa e konsumatorëve të aprovohet. Në përputhje me këtë nuk ka ndryshim në dokumentin e OSSH, por KOSTT ka sugjeruar ndryshime në dokumentin e OST-së të cilat janë inkorporuar në versionin përfundimtar të atij dokumenti.

3.9 Kyçjet për ngarkesa

Draft dokumentet propozuan që vendimet në përcaktimin se a duhet të jetë një ngarkesë e thellë apo e cekët duhet të mbështetën në madhësinë e kyçjes së re në krahasim me kapacitetin e sistemit në pikën e kyçjes, dhe nëse përforcimet që janë të nevojshme për të akomoduar kyçjen ishin tashmë të parapara në Planin zhvillimor të të licencuarit për shpërndarje apo transmision.

KEK sugjeroi që vendimi për përcaktimin e ngarkesave për kyçje e thellë apo e cekët i bërë në lidhje me Planin zhvillimor të shpërndarjes mund të jetë kontrovers.

KOSTT propozoi një test alternativ për kyçjen e thellë kundër asaj të cekët në lidhje me rikthimin e mundshëm të kostove të përforcimit që shkaktohen nga kyçjet e vogla. KOSTT sugjeroi një pikë ndarëse në mes të përcaktimit të ngarkesave e cekët dhe e thellë sipas kostos së përforcimeve duke qenë dhjetë herë ngarkesat e mundshme vjetore të TUOS për kyçje. Gjatë diskutimeve me KOSTT mbi këtë çështje, KOSTT u pajtua që testi në lidhje me Planin zhvillimor mbetet i përshtatshëm.

ZRRE konsideron se testi i Planit zhvillimor të mbetet relevant për OSSH dhe OST për t'iu shmangur asaj që parashtruesit e kërkesave të mos kërkojnë të financojnë zhvillimet tashmë të parashikuara nga të licencuarit, dhe se testi i mëtutjeshëm i propozuar i KOSTT i shumës së kostove të përforcimit është i përshtatshëm për vendimet e përcaktimit të ngarkesave në transmision. Dokumentet janë amendamentuar në përputhje me këtë.

KOSTT vërejti se në një aspekt të veçantë të kësaj çështje që efekti i kyçjeve ilegale në furnizimet e konsumatorëve të tjerë nuk është adresuar. ZRRE konsideron që kjo është një çështje e rëndësishme, por se është jashtë fushëveprimit të parimeve të përcaktimit të ngarkesave të rrjetit dhe nuk duhet të adresohet në këtë dokument.

3.10 Marrëveshjet kontraktuese

KOSTT vëren se marrëveshjet e saja kontraktuese, duke përfshirë marrëveshjet e faturimit sipas Rregullave të tregut, adresojnë kërkesat e Neneve 10 dhe 15 të draft dokumentit të OST-së. ZRRE

Hyrje

konsideron që marrëveshjet për marrëdhënie kontraktuese duhet të adresohen në Metodologjinë e përcaktimit të ngarkesave të të licencuarit e jo në dokumentet e parimeve për përcaktimin e ngarkesave.

3.11 Hyrja e ngarkesave në fuqi

KEK propozoi që ngarkesat për kyçje duhet të hyjnë në fuqi brenda 60 ditëve pas dërgimit të tyre tek Rregullatori. ZRRE vëren se kjo është në kundërshtim me dispozitat e Nenit 16.7 të Ligjit mbi Energjinë Elektrike i cili thotë se kushtet e përgjithshme, duke përfshirë tarifat, i nënshtrohen aprovimit, dhe e refuzon këtë propozim.

Megjithatë, në përgjigje ndaj sugjerimeve të KEK-ut dhe KOSTT-it, ZRRE ka sqaruar hapat procedurale në lidhje me aprovimin dhe modifikimin e dokumenteve të parimeve të përcaktimit të ngarkesave.